



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr.134, Datë 18.12.2009

**Për
përcaktimin e hapave të hetimit të thelluar në tregun e produktit lëndë
djegëse diesel D2 për ndërmarrjen “ARMO” SHA,**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|-----------|-------------|---------|
| • Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • Servete | GRUDA | Anëtar |
| • Koço | BROKA | Anëtar |
| • Rezana | KONOMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 18.12.2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përcaktimi i hapave të kryerjes së Hetimit të Thelluar në tregun e produktit lëndë djegëse diesel D2 për ndërmarrjen “ARMO” SHA.

Baza ligjore:

- Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të Vendimit Nr.129, datë 19.11.2009, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e produktit lëndë djegëse diesel (D2) për ndërmarrjen “ARMO” SHA”:

V E N D O S I:

- I. Përcaktimin e fazave të kryerjes së Hetimit të Thelluar si vijon:
 - a) Inspektime në ndërmarrjen nën hetim;
 - b) Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
 - c) Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
 - d) Hartimi i Raportit Përfundimtar të Hetimit të Thelluar dhe paraqitja e tij përpara Komisionit.
- II. Sekretari i Përgjithshëm të miratojë Matricën e Veprimeve të Hetimit të Thelluar sipas hapave të përcaktuar më sipër në këtë vendim.
- III. Afati i fundit për kryerjen e këtij hetimi është data 30.01.2010.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Rezana Konomi

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R